**AKT-THEMELIMI**

**I**

**"HAWAI-ALB" Sh.p.k**

Sot ne date 20.01.1997 une i nenshkruari ELSAYED METWALLY ABDELRAHMAN lindur me 13.02.1941 ne Port Said dhe me banim ne Port Said Egjypt, shtetas egjyptian me Nr.pasaporte 20800, me cilesine e Ortakut te vetem, konfor ligjit shqiptar "Per Shoqerite Tregetare"

**V E N D O S A:**

1. Themelimin e HAWAI-ALB Sh.p.k
2. Selia e Shoqerise eshte ne Rr."Sh.Dishnica" Nr.72 Tirane.
3. Administratori i Shoqerise eshte ELSAYED METWALLY ABDELRAHMAN
4. Objekti i veprimatarise se Shoqerise do te jete: Investime ne ndertime, turizem, transport, export-import mallrash, Shitblerje trojesh etj.
5. Kapitali themelor ne castin e krijimit te Shoqerise eshte **108 600 Leke** ([illegible]je) lek Afati i veprimtarise 25 vjet.
6. Shoqeria merr persiper te kryeje aktivitetin e saj, konform dispozitave te Statutit, ligjit "Per Shoqerite Tregetare" dhe legjislacionit shqiptar.

**Ortaku i Vetem**

**ELSAYED METWALLY ABDELRAHMAN**

# S T A T U T

## E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

## "HAWAI-ALB"

Ky statut hartohet nga ortaku i vetem z.ELSAYED METWALLY ABDELRAHMAN shtetas egjyptian me Nr.pasaporte 20800lindur me 13.02.1941 ne Port-Said, banues ne Port Said, Egjipt.

### I-REGJIMI JURIDIK

**NENI 1**

Ne baze te legjislacionit shqiptar dhe Aktit te Themelimit HAWAI-ALB ka statusin juridik te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar.

**NENI 2**

Ortaku i vetem mund te ndryshoje regjimin juridik te Shoqerise, neqofte se kryhen premisa me te favorshme per funksionimin e saj. Ne keto raste behen pershtatjet ne statut dhe behen regjistrimet perkatese ne gjykaten kompetente.

**NENI 3**

Shoqeria fituon statusion e eprsonit juridik nga dita e regjistrimit ne gjykaten kompetente dhe fillon aktivitetin pas plotesimit te te gjitha kerkesave te nevojshme qe kushtezon legjislacioni shqiptar.

**NENI 4**

Selia e Shoqerise ndodhet ne Rr."Sh.Dishnica" 72, Tirane. Shoqeria mund te krijoje edhe agjenci apo simotra brenda ose jashte Republikes Shqiperise. Afati i veprimtarise 25 vjet.

**NENI 5**

Shoqeria disponon siglen dhe vulen e saj konfiguracioni i te cilave percaktohet menjehere pas krijimit te saj.

### II.OBJEKTI I VEPRIMTARISE

**NENI 6**

Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te zhvillohet ne keto drejtime kryesore:

a. Tregeti me shumice dhe pakice dhe eksport-import mallrash, brenda dhe jashte Shqiperise.

b. Aktivitete turistike:
   - Celje restorantesh dhe hotelesh
   - Kampinge dhe fshatra turistike
   - Agjenci turistike

c. Investime ne ndertime
   - Investime publike
   - Investime te godinave te banimit
   - Investime ne infrastrukture
   - Blerje dhe shitje trojesh dhe dhenie me qera e tyre dhe ndertesave.

c. Investime ne transport
   - Transport detar
   - Transport automobilistik
   - Transport ajror

### NENI 7

Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje e te nenshkruaje kontrata sipas ligjit me kedo qe ajo e cmon te nevojshme.

## III.ADMINISTRIMI I SHOQERISE

### NENI 8

Shoqeria udhehiqet e drejtohet nga Administratori i saj z.ELSAYED METWALLY ABDELRAHMAN.

### NENI 9

Administratori e ushtron veprimtarine e tij ne perputhje me statutin dhe legjislacionin shqiptar ne fuqi.

### NENI 10

Administratori ka keto kompetenca kryesore:

- Organizon e bashkerendon veprimtarine e Shoqerise.
- Nenshkruan ne emer te Shoqerise marreveshje, kontrata, rregullore te veprimtarise se saj si dhe cdo korrespondence tjeter.
- Sipas gjykimit te tij krijon ose eliminon hallka administrative brenda Shoqerise.
- Perfaqeson Shoqerine ne rastin e konflikteve administrative ose ne Gjykate ose autorizon me prokure presona te tjere.

## IV CESHTJE FINANCIARE

### NENI 11

Kapitali themelor ne castin e krijimit te HAWAI-ALB Sh.p.k eshte 108 000 Leke (ind[illegible] ) leke.

**NENI 12**

Me fillimin e aktivitetit Shoqeria krijon mjete monetare e materiale te cilat do t'i disponoje ne perputhje me dispozitat e ketij statuti dhe legjislaconin ne fuqi.

**NENI 13**

Shoqeria do te kete llogarine rrjedhese te saj ne nje nga bankat e Tiranes. Ajo mund te hape llogari edhe ne banka te tjera brenda dhe jashte Shqiperise ne perputhje me legjislacionin perkates.

**NENI 14**

Shoqeria mund te hape llogari ne banke ne monedha vendase dhe te huaj. Te gjitha shpenzimet qe kryhen ne valute duke perfshire edhe fitimet, shoqeria i siguron nepermjet aktiviteteve qe burojne nga aktiviteti i saj, konvertimi i lekut vendos me valute te huaj si dhe nepermjet te gjitha menyrave te tjera qe lejon ligji . Shumat ne leke konvertohen perkatesisht me kursin zyrtar te dites ne te cilen kryhet kembimi.

**NENI 15**

Shoqeria mbron prane administrates se saj, librat kontabile dhe dokumentacionin tjeter te nevojshem ekonomiko-financiar. Brenda 3-mujorit te pare te vitit ekonomiko-financiar paraqitet Raporti Administrativ dhe Bilanci Vjetor per vitin e meparshem.

**NENI 16**

Viti ne kuptimin ekonomiko-financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon ne 31 Dhjetor te vitit kalendarik.

**NENI 17**

Fitimi neto perdoret sipas vendimeve qe gjykon te marra Administratori.

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**NENI 18**

Marredheniet e punes ne Shoqeri do te rregullohen sipas dispozitave te rregullave te brendshme e ne perputhje me Kodin e Punes se Republikes se Shqiperise

**NENI 19**

Shoqeria e penalon aktivitetin ne rastet kur:

- Administratori vendos te mbylle aktivitetin
- Vertetohen rastet e forces madhore
- Aktiviteti i saj bie ne kundershtim me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

**NENI 20**

Ne rastet e mbylljes se aktivitetit te Shoqerise, ajo i nenshtrohet procedures se likujdimit, konform dispozitave te ligjit "Per Shoqerite Tregetare".

**NENI 21**

Mosmarreveshjet qe mund te lindin ne zbatim te ketij Statuti mund te zgjidhen prane Gjykates Tirane ose ne Chomber of Commerce me qender ne Paris.

**NENI 22**

Statuti u hartua ne kater njesi me vlere te barabarte

**Ortaku i vetem i**

**HAWAI-ALB Sh.p.k**

**ELSAYED METWALLY ABDELRAHMAN**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
N O T E R I A
Nr. 519 ...Rep.
Nr. 225 ..Kol.

V E R T E T I M

Sot ne daten 22.I.1997, diten e merkure, para meje noteres Myrvete Permeti, notere ne Dhomen e Noterise se Tiranes, u paraqit personalisht Elsayed Metwally Abdelrahman, lindur ne vitin 1941, banues ne Egjypt, Port Said ; me numer pasaporte 20800, i cili firmosi kete statut dhe akt themelimi. Une noteri pasi e gjeta konform ligjes e vertetova si me poshte.

N o t e r e
Myrvete Permeti